

20130691464

L I G J
PËR VENDOSJE TË SISTEMIT PËR MENAXHIM ME CILËSI DHE KORNIZËS SË
PËRBASHKËT PËR VLERËSIM TË PUNËS DHE DHËNIES SË SHËRBIMEVE NË
SHËRBIMIN SHTETËROR

Kapitulli i parë

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda e rregullimit të Ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet vendosja e sistemit për menaxhim me cilësi dhe kornizës së përbashkët për vlerësim të punës dhe dhënies së shërbimeve në shërbimin shtetëror.

Neni 2

Sistemi për menaxhim me cilësi dhe korniza e përbashkët për vlerësim në shërbimin shtetëror bazohen në standarde ndërkombëtare apo maqedonase me të cilat vendosen kërkesa të veçanta për sistemin për menaxhim me cilësi dhe kornizën e përbashkët për vlerësim të punës dhe dhënies së shërbimeve në shërbimin shtetëror.

Qëllimi i Ligjit

Neni 3

Qëllimi i këtij ligji është vendosja e standardeve ndërkombëtare apo maqedonase të sistemit për menaxhim me cilësi dhe kornizës së përbashkët për vlerësim të punës dhe dhënies së shërbimeve në shërbimin shtetëror për sferën përkatëse me çfarë do të sigurohet cilësi më e mirë e shërbimeve në shërbimin shtetëror.

Lista e nocioneve

Neni 4

Nocione të veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin në vijim:

1. **Shërbim shtetëror** sipas këtij ligji, janë organet e pushtetit shtetëror dhe lokal dhe organet tjera shtetërore, të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe me ligj (në tekstin e mëtejshëm: organe);

2. **Menaxhim me sistemin për menaxhim me cilësi** paraqet qasje në sistem që i konkretizon dhe realizon kërkesat për: planifikim cilësor, zbatim, kontroll dhe qëndrueshmëri, si dhe përmirësim të vazhdueshëm të punës së organeve;

3. **Standarde ndërkombëtare dhe maqedonase për sisteme për menaxhim me cilësi** janë standarde me të cilat definojnë kushtet minimale të nevojshme për punë cilësore të organeve;

4. **Sistemi për menaxhim me cilësi** paraqet realizim të standardeve ndërkombëtare dhe maqedonase të cilat mbulojnë aspekte të ndryshme të menaxhimit me cilësinë dhe paraqet instrument nëpërmjet të cilit sigurohet që realizimi i kompetencave të jetë në pajtim me kërkesat e shfrytëzuesve për avancim të vazhdueshëm të cilësisë së punës së organeve dhe

5. **Kornizë e përbashkët për vlerësim** është Instrumenti evropian për menaxhim me cilësi në sektorin publik, me të cilin Organizatat evropiane të sektorit publik, nëpërmjet metodës së vetëvlerësimit, me përfshirje të të punësuarve, përpilojnë plan për përmirësim të cilësisë së punës së tyre.

Kapitulli i dytë

VENDOSJA E STANDARDEVE DHE INSTRUMENTEVE PËR MENAXHIM ME CILËSI

Vendosja e standardeve për menaxhim me cilësi

Neni 5

(1) Në organet, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit me cilësinë në punën dhe dhënien e shërbimeve vendoset së paku standardi themelor ISO 9001, e varësisht nga kompetencat e organeve mund të vendosen edhe tipa tjerë ISO ose standarde maqedonase, që do ta plotësojnë standardin themelor, e që kanë të bëjnë me specifikat e organeve.

(2) Nëse organet kanë nevojë për vendosje të më shumë standardeve ISO apo standardeve maqedonase, atëherë i qaset vendosjes së sistemit të integruar për menaxhim, të përbërë nga më shumë standarde ISO, ku baza është ISO 9001, ndërsa standardet tjera varen nga specifikat e organeve.

(3) Trupi i certifikuar i cili do të kryejë certifikim të organeve doemos duhet të jetë i akredituar nga Instituti për Akreditim i Republikës së Maqedonisë në pajtim me rregullat për akreditim.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës miraton program me listë prioritare të organeve nga neni 4 paragrafi (1) alineja (1) e këtij ligji, për vendosje të standardeve për menaxhim me cilësi.

Vendosja e kornizës së përbashkët për vlerësim

Neni 6

(1) Për përmirësim të menaxhimit me cilësinë në punën dhe dhënien e shërbimeve në organe, vendoset kornizë e përbashkët e vlerësimit nëpërmjet përfshirjes së të punësuarve dhe vetëvlerësimit, në bazë të orientimeve dhe udhëzimeve të përpiluara nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(2) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës detyrohet që t'i publikojë orientimet dhe udhëzimet nga paragrafi (1) i këtij neni në ueb faqen e vet.

Neni 7

Organet mjetet për vendosje të standardeve dhe instrumenteve nga nenet 5 dhe 6 të këtij ligji, i sigurojnë nga buxheti i vet.

Koordinimi i mënyrës së menaxhimit me sistemin për menaxhim me cilësi dhe kornizën e përbashkët për vlerësim

Neni 8

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, formon Trup koordinativ për menaxhim me sistemin për menaxhim me cilësi dhe kornizën e përbashkët për vlerësim të punës dhe dhënies së shërbimeve në shërbimin shtetëror me propozim të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(2) Me Trupin koordinativ nga paragrafi (1) i këtij neni, kryeson ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(3) Punët administrative teknike për nevojat e Trupit koordinativ nga paragrafi (1) i këtij neni, i kryen Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(4) Trupi koordinativ më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhës, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë parashtron raport për progresin e vendosjes së standardeve për menaxhim me cilësi dhe kornizës së përbashkët për vlerësim për vitin e kaluar.

Neni 9

Në organet përcaktohet vendi i punës që e koordinon procesin e vendosjes së standardeve dhe instrumenteve për menaxhim me cilësi.

Neni 10

Organet e mbajnë sistemin e vendosur të menaxhimit me cilësi dhe kornizën e përbashkët për vlerësim në pajtim me standardin e vendosur për menaxhim me cilësi.

Kapitulli i tretë

МБИКËQYRJA

Neni 11

(1) Inspektorati Shtetëror Administrativ kryen mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji.

(2) Mbikëqyrjen nga paragrafi (1) i këtij neni, e kryejnë inspektorët në pajtim me ligjin.

(3) Inspektori i ka autorizimet e përcaktuara me ligj.

Kapitulli i katërt

DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Neni 12

(1) Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 8 000 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i kumtohet funksionarit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, nëse nuk vendosen standardet dhe instrumentet nga nenet 5 dhe 6 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 750 deri në 4 000 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i kumtohet personit i cili punon në vendin e punës nga neni 9 i këtij ligji, nëse nuk ndërmerr aktivitete për vendosje të standardeve dhe instrumenteve nga nenet 5 dhe 6 të këtij ligji.

(3) Para parashtrimit të kërkesës për ngritje të procedurës kundërvajtëse në gjykatën kompetente zbatohet procedurë për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(4) Procedurën kundërvajtëse për kundërvajtjet e parapara në këtë ligj, e udhëheq gjykata kompetente.

Kapitulli i pestë

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 13

(1) Trupat ekzistues për certifikim, të cilët kanë kryer certifikim deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë t'i kryejnë punët e certifikimit nëse marrin akreditim nga Instituti për Akreditim i Republikës së Maqedonisë në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Organet të cilat paraprakisht e kanë marrë standardin ISO 9001, detyrohen që pas kalimit të afatit për të cilin janë certifikuar të kryejnë certifikim te trupi i akredituar nga Instituti për Akreditim i Republikës së Maqedonisë.

Neni 14

Trupin koordinues nga neni 8 paragrafi (1) i këtij ligji, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta formojë në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 15

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës detyrohet që orientimet dhe udhëzimet nga neni 6 i këtij ligji, t'i përpilojë edhe publikojë në ueb faqen e vet në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 16

Organet t'i harmonizojnë aktet për sistematizim të vendeve të punës me dispozitat e këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 17

Organet nga neni 4 paragrafi (1) alineja (1) të këtij ligji, detyrohen që procedurën për standardet për menaxhim me cilësi nga neni 5 i këtij ligji, ta fillojnë nga 1 janari 2014, përveç ministrive të cilat procedurën për standardet për menaxhim me cilësi nga neni 5 i këtij ligji, detyrohen që ta fillojnë më së voni deri më 1 janar 2014.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç dispozitave nga neni 6 i këtij ligji të cilat do të fillojnë të zbatohen një vit nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.